

## Fleta e punës për nxënësit 7.1


### A është sundimi i shumicës ndaj pakicës i padrejtë? Një studim rasti

Një klub sportiv ka një numër të madh lojtarësh volejboli të mirë dhe një numër më të vogël lojtarësh që kanë prirje në lojën e shahut. Të dy grupet marrin pjesë në garat e kampionatit dhe kanë pasur sukses në tërheqjen e anëtarëve të rinj. Çdo anëtar paguan të njëjtin kontribut vjetor për klubin. Një herë në vit, mbahet një takim, në të cilin, të gjithë anëtarët vendosin me shumicë votash se si të shpenzojnë paratë. Lojtarët e volejbollit kanë një listë të gjatë kërkesash, duke përfshirë furnizimin e rregullt me topa të rinj, veshje të reja për ekipin e tyre dhe përmirësimin e fushës së volejbollit. Lojtarët e shahut kanë nevojë për materiale trajnimi për fillestarët, për libra dhe revista, si dhe për një dhomë më të madhe, me më shumë tabela shahu, më shumë tavolina dhe karrige për arsye të numrit në rritje të anëtarëve.

Folësit e lojtarëve të volejbollit dhe të shahut paraqesin rastet e tyre. Në vjim, merret një vendim me shumicë votash. Çdo vit, grupi i vogël i shahut mundet nga mbivotimi i lojtarëve të shumtë të volejbollit. Të gjitha paratë shkojnë në projektet e volejbollit dhe lojtarët e shahut duhet ta shtynë me atë që kanë.

Lojtarët e shahut janë të zhgënjyer dhe kanë humbur durimin. Në fund të fundit, kontributet e tyre po shpenzohen për projektet e volejbollit. Ata ndjehen si anëtarë të shpërfillur dhe disa prej tyre janë shprehur për ndarjen në dy klube të veçanta.

Shumica e lojtarëve të volejbollit tunden kokat e tyre. Rregullat e shumicës - kjo është demokracia. Dhe në qoftë se ju mundeni nga mbivotimi - kjo është pjesë e lojës. Por, disa nga lojtarët e volejbollit e ndjejnë se kjo pikëpamje është pak si tepër e thjeshtë. Lojë e ndershme do të thotë se edhe interesat e lojtarëve të shahut duhet të meren parasysh. Por si?



*Struktura e anëtarësimit në klubin sportiv - një shembull i thjeshtë i pluralizmit. Shoqëritë pluraliste kanë të njëjtën lloj strukture, por sigurisht më komplekse. Grupe të ndryshme kanë interesa të ndryshme që mund të konkurrojnë me njëri-tjetrin. Sa më komplekse të jetë një shoqëri, aq më shumë mundësi ka për konflikt të interesave. Demokracia dhe të drejtat e njeriut japin mjete për të zgjidhur këto konflikte në mënyrë të drejtë, domethënë në mënyrë paqësore.*

Studim Rasti përshtatur nga: David Miller, *Filozofia politike. Një hyrje e shkurtër*. Oxford, 2003, f. 5.